



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.55/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fato Ademi kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Arsić Predrag, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si i bazuar apeli Anr.55/2019. i Arsić Predrag, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, **URDHËROHET** KQZ-ja të përfshijë votuesin Arsić Predrag, në listat e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit Arsić Predrag, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 06.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

Në përgjigjen e KQZ-se të datës 21.09.2019 theksohet se parashtruesi i apelit Arsić Predrag, ka dërguar kopje të dokumentit të identifikimit së bashku me formularin por nuk ka dërguar një kopje të dokumentit identifikues me të cilin dëshmohet se plotëson njërin nga kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës .

PZAP-i pas që shqyrtoj apelin vlerësoj se:

Apeli është i bazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në momentin e aplikimit të njëjtin nuk e ka regjistruar si votues jashtë Kosovës, por Paneli gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se e njëjta ka kopje të dokumenteve valide me të cilat plotëson kushtet për t'u përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës. Prandaj paneli, ka konstatuar se apeli ka mbështetje ligjore në nenin 3.1, pika a), e

Rregullës Zgjedhore nr.03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedhë fletëvotimin për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë rregull të zgjedhjeve*”, pasi që në rastin konkret parashtruesi i apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.55/2019 më datën 22.09.2019.



**Kryesuese e Panelit
Faton Ademi**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.